

Bullgaria: Shteti livron mjete për shkollat fetare



Mbi 2 mln euro livroi qeveria për financimin e shkollave fetare në Bullgari gjatë vitit 2021. Kryeministri Bojko Borisov theksoi rëndësinë e arsimit në këto shkolla. “Ato janë jashtëzakonisht të rëndësishme për tolerancën etnike dhe për bashkëjetesën paqësore, për njohjen e feve, që të dihet se ato predikojnë paqe dhe jo luftë” - tha Borisov.

Shuma do të shpërndahet mes pesë shkollave fetare në vend, të hapura me kërkesë të Kishës Ortodokse Bullgare dhe Kryesisë së Komunitetit Mysliman. Pagat e figurave fetare dhe pedagogëve në këto shkolla janë të barabarta me ato të mësuesve në arsimin e mesëm.